ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINORE DHE INFRASTRUKTURËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **210-24-3216-5-1-1 & MMPHI 205 24 011 511**

Sa i përket tenderit për : **"Pastrimi i lumenjëve në nivel të Kosovës"**
LOT 2 Lumi Toplluha, Velezha -Prizren L=11500m

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*
"VB.TOFAJ" SH.P.K & "NIVA CONSTRUCTION" SH.P.K & "HARST GROUP" SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

JUNIK – QENDËR

(Adresa)

JUNIK **51050**

(Vendi) *(Kodi postar)*

044/466-694 **0390/370-633**

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

FERAT (NIMON) TOFAJ

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

vbtofaj-shpk@hotmail.com

(Adresa elektronike)

03.07.2024

(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

Sh.p.k. VB.TOFAJ 810962193 JUNIK

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë është publikuar me dt. 05.04.2024 Procesverbali i hapjes së ofertave dt. 16.05.2024 Njoftimi mbi vendimin e AK dhe Letra Standarde dt. 20.06.2024 Kërkesë për qasje ne dokumente dt. 20.06.2024 Përgjigje për qasje ne dokumente dt. 20.06.2024 Kërkesa për rishqyrtim dt. 25.06.2024 Vendimi mbi pezullimin e aktivitetit të prokurimit dt. 25.06.2024 Vendimi mbi refuzim të kërkesës për rishqyrtim dt. 01.07.2024 Kriteret për dhënie të kontratës është Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Pas Njoftimi mbi vendimin e AK për dhe Letra Standarde dt: 20.06.2024 kemi bërë kërkesë për qasje ne dokumente dt: 20.06.2024 ku me të njëjtën datë kemi pranuar përgjigje se mund të kemi qasje.
Me datë: 25.06.2024 kemi bërë kërkesë për rishqyrtim për **LOT 2 Lumi Toplluha, Velezha -Prizren L=11500m** për kompaninë e cila është menduar të shpërblehet me kontratë, konkretisht për Grupin e Operatorëve Ekonomik **FLED & EUROFAMIS SH.A**, kurse Operatorët tjerë i ka eliminuar AK.
Me datë: 25.06.2024 kemi pranuar nga Autoriteti Kontraktues - Vendimin mbi pezullimin e aktivitetit te prokurimit, ndërsa me datë: 01.07.2024 kemi pranuar nga AK – Vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim si te pabazuar.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të Ligji Nr. 04/L-042, për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, si vijon:

1. Neni 7 Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi paragrafi 1
2. Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes paragrafi 1 dhe 2,
3. Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve paragrafi 4,
4. Neni 70 Standardet për Sigurimin e Cilësisë

Rregullore Nr. 001/2022 për prokurimin publik:

1. Neni 26 paragrafi 26.6

Udhëzues Nr.001/2023 për prokurimin publik

1. Neni 5. SPECIFIKIMET TEKNIKE -paragrafi 5.6
2. Neni 10 Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve tabela 10.1,

Fleta e të dhënave të tenderit: Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale Neni 9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues me ane këtij vendimi mbi refuzimin e kërkesë për rishqyrtim vazhdon të bëjë shkelje të LPP, Rregullores dhe Udhëzuesit për prokurim publik të neneve të lartcekur, duke devijuar nga kërkesat dhe dëshmitë e kërkuara FDT dhe në Njoftimin për kontratë.

Ne si GOE në kërkesën për rishqyrtim kemi bërë gjashtë (6) gjetje -pretendime ku kemi treguar shkeljet që ka bërë AK dhe Komisioni i vlerësimit të cilët kanë menduar të shpërblejnë me kontratë Grupin e Operatorëve Ekonomik **FLED & EUROFAMIS SH.A,** edhe pse ne ju kemi bashkangjitur dëshmi për secilin pretendim.

Ne qëndrojmë prapa pretendimeve tona të cilat i kemi bërë në kërkesën për rishqyrtim e të

cilat janë si vijon:

Pretendimi nr. 1 AK në këtë rast ka bërë shkelje LPP Te Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve paragrafi 4 ku thuhet: *"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve".*

Pasi që ka rekomanduar për kontratë GOE FLED & EUROFAMIS SH.A, edhe pse GOE nuk është i përgjegjshëm sipas FDT të Kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale Neni 9.1 & 9.2 ku është kërkuar:

Kapaciteti teknik dhe professional:

Të gjitha Lotet OE duhet të dëshmojë së është i certifikuar me ISO 9001 2015, ISO 14001 2015 dhe ISO 45001 2018 . Certifikata duhet të janë me afat valid. Certifikatat duhet t'i kanë të gjitha shënimet e detajuar për verifikim.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

OE duhet të dorëzojë Certifikata profesionale (kopje e noterizuar). (Fushëveprimi Ndërtim të lartë ose ulët) . Vërejte Autoriteti kontraktues rezervon te drejtën për informacione shtesë nga Institucioni për lëshimin e këtyre Certifikatave.

Ndërsa OE EUROFAMIS SH.A ka prezantuar ISO të cilat nuk plotësojnë Kërkesat e FDT sepse Fushëveprimi që është kërkuar është (Fushëveprimi Ndërtim të lartë ose ulët) , ndërsa OE i lartpërmendura Fushëveprimin ne ISO e ka (Zhvillim i projekteve të ndryshme).

Noterizimet e prezantuar për ISO nga ARTA MORINA MUSTAFA – nuk shkruan se nga kush është lëshuar CERTIFIKATA apo nr. i CERTIFIKATËS po te noterizimet shkruan si vijon: " Vërtetoj se : Ky dokument, përndryshe kopja e origjinalit të dokumentit të titulluar "CERTIFIKATË" në të gjitha pikëpamjet kopja është konform me origjinalin e cila i'u ka parashtruar noteres."

Po ashtu AK po për të njëjtin Kërkesë të dosjes dhe FDT ka bërë shkelje të UDHËZUESI NR. 001/2023 PËR PROKURIM PUBLIK - Neni 5. SPECIFIKIMET TEKNIKE -paragrafi 5.6 ku thuhet: " *Specifikimet teknike janë kërkesa të obligueshme, të cilat të gjithë tenderët duhet të respektojnë në mënyrë që të jenë të përgjegjshëm* " .

Si dhe ka bërë shkelje të RREGULLORE NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK - Neni 26 GRUP I OPERATORËVE EKONOMIK - paragrafi 26.6 ku thuhet:"*Çertifkatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon çertifkata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse".*

Në këtë rast Lideri i GOE FLED nuk ka prezantuar asnjë ISO që është kërkuar në FDT.

Provë: ISO E PREZNATUARA NGA EUROFAMIS NDERSA NGA LIDERI NUK JAN PREZANTUAR FARE

Përgjigja e AK lidhur me pretendimin e lart cekur

Pas shqyrtimi te gjitha pikave te ankimimit te parashtruar ne pretendimin 1, AK ju njofton edhe një here se i gjithë vlerësimi i ofertave është bere konform dispozitave Ligjore Rregullave dhe Udhëzuesit për Prokurim Publik, andaj edhe ky pretendim nga ana e juaj nuk përmban fake as argumente për qka ju pretendoni.

Ndërsa OE e ka përmbushur ketë kërkesë pasi qe ISO kane qene sipas kërkesës andaj edhe AK i ka pranuar si kërkesës e përmbushur. Ndërsa kërkesë ka qene qe OE te ofroj ISO pa e përcaktuar qe lideri duhet te ofroj ketë kërkesë por cili do nga anëtaret e grupit qe e ka ofruar konsiderohet si kërkesës e përmbushur nga ana e GOE. **Kerkesa ka qene shume e qart ku thuhet :Të gjitha Lotet OE duhet të dëshmojë së është i certifikuar me ISO 9001 2015, ISO 14001 2015 dhe ISO 45001 2018 . Certifikata duhet të janë me afat valid. Certifikatat duhet t'i kanë të gjitha shënimet e detajuar për verifikim., bazuar ne kete kërkesë OE i ka dorzuar çertifikata te njetit standar sipas kerkeses, ndersa sa i përketë fushe veprimtarise AK vlereson se çertifikata e prezentuar nga ana e GOE I ka permbushur edhe fushune e veprimtarise pasi qe kane te bejen me zhvillimin e projekteve te ndetimit ku ne kuadert te ndertimit hyne edhe ndertimi I ulete edhe ndertimi I lart.**

Sa I përket pretendimit për NOTERIZIMIN e certifikatave ju informojmë se në FDT kërkesë ishtë që: OE duhet të dorëzojë Certifikata profesionale (kopje e noterizuar).
Te gjitha certifikatat e ofruara nga GOE i rekomanduar janë të noterizuara konformë kërkesës së FDT-së dhe forma se si është bërë NOTERIZIMI nuk është kërkesë e FDT-së.

Nje shembull I dokumeteti te kerkuar dhe noterizuar qe OE I ka prezentuar ne oferten e tij:

Në FDT ka qenë shume qartë e specifikuar OE duhet të dëshmoj se është i certifikuar me ISO, ku (OE d.m.th secili operator ekonomik) siç thuhet edhe të RREGULLORE NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK - Neni 26 GRUP I OPERATORËVE EKONOMIK - paragrafi 26.6 ku thuhet:"*Çertifkatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon çertifkata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse".* Askund në FDT nuk shkruan siç pretendon AK "cili do nga anëtaret e grupit që ka ofruar konsiderohet si kërkesë e përmbushur nga ana e GOE", në këtë rast AK bije në kundërshtim me kërkesat e vendosur vetë në FDT dhe në njoftimin për kontratë.
Po ashtu AK është munduar të bëjë një krahasim të ISO të dorëzuar nga ne si GOE dhe GOE që konsiderojnë të përgjegjshëm.
Në të gjitha ISO që ne kemi prezantuar si GOE përshkrimi i fushës së aktivitetit është i specifikuar për ndërtime të ulëta dhe të larta ndërsa PARTNERI I GOE të propozuar për kontratë ka prezantuar ISO ku fusha e aktivitetit ka të bëjë me ZHVILLIM TË PROJEKTEVE TË NDËRTIMIT, ndërsa Lideri nuk ka prezantuar fare e që është në kundërshtim me Rregullore nr. 001/2022 të lartcekur.

Provë shtesë: ISO E PREZAMNTUAR NGA NE SI GOE

Pretendimi 2. AK në këtë rast ka bërë shkelje LPP Te Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve paragrafi 4 ku thuhet: *"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve".*

Sepse GOE nuk është i përgjegjshëm sipas FDT të Kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale Neni 9.1 & 9.2 ku është kërkuar

Kapaciteti teknik dhe professional:
Operatori ekonomik ose grupi i Operatoreve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses projekte në rregullim ose pastrim të lumenjeve, për 3 vitet e fundit. Në rast të grupit, Lideri duhet të ketë së paku 60% të totalit. LOT 1 447,750.00 euro
LOT 2 513,900.00 euro
LOT 3 613,500.00 euro
LOT 4 274,728.00 euro
LOT 5 305,364.00 euro
LOT 6 187,260.00 euro
LOT 7 346,212.00 euro
LOT 8 269,000.00 euro

Dëshmia e kërkuar dokumentare
Një Listë të projekteve të realizuara ne tri vitet e fundit, me te cilën specifikohen te gjitha projektet e punëve dhe aktiviteteve për rregullim ose pastrim te lumenjeve per tri vitet e fundit Origjinal e vulosur dhe e nënshkruar nga përfaqësuesi i OE. Për projektet e përfunduara lista duhet ti ketë këto te dhëna Titullin e kontratës, Investitori dhe të dhënat e personit kontaktues, Datën e fillimit të kontratës, Datën e përfundimit të projektit, vlerën e projektit. Referenca ose raporte te pranimit te punimeve.

Asnjë referencë e prezantuar nga Lideri i grupit i cili është FLED nuk është sipas të cilës është kërkuar në dosjen e tenderit dhe në FDT ku thuhet citoj: "Operatori ekonomik ose grupi i Operatoreve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses projekte në rregullim ose pastrim të lumenjve, për 3 vitet e fundit. Në rast të grupit, Lideri duhet të ketë së paku 60% të totalit. LOT 2 513,900.00 euro ".
Kërkesa ka qenë shume e qartë ku referencat janë kërkuar Projekte rregullim ose pastrim të lumenjve..
Ndërsa partneri i tije ka i tije EUROFAMIS SH.A ka prezantuar vetëm dy (2) referenca të ngjashme por të cilat nuk vlejnë sepse janë me dt. të përfundimit 11.11.2020 dhe18.12.2020 të cilat janë në kundërshtim me Kërkesat e FDT sepse aty thuhet... ka përfunduar me sukses projekte në rregullim ose pastrim të lumenjve, për 3 vitet e fundit.

Pra AK dhe komisioni i vlerësimit kanë bërë shkelje të **Udhëzues Nr.001/2023 për prokurimin publik Neni 10 Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve tabela 10.1** ku thuhet:

Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës se përcaktuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

Në këtë raste GOE është dashur që të eliminohet pasi që dëshmitë e ofruara nuk përmbushë kërkesën e FDT – dhe njoftimit për kontratë .

Provë: Lista e projekteve të prezantuar

Përgjigja e AK lidhur me pretendimin e lart cekur

Lista e projekteve për rregullim dhe pastrim të lumejve 60% lideri, kërkesa në vlerës prej: 513,900.00 euro.
AK ka kërkuar që për këtë kërkesë të FDT-së GOE të ofrojë dëshmi:

Një Listë të projekteve të realizuara ne tri vitet e fundit, me te cilën specifikohen te gjitha projektet e punëve dhe aktiviteteve për rregullim ose pastrim te lumenjeve për tri vitet e fundit Origjinal e vulosur dhe e nënshkruar nga përfaqësuesi i OE. Për projektet e përfunduara lista duhet ti ketë këto te dhëna Titullin e kontratës, Investitori dhe të dhënat e personit kontaktues, Datën e fillimit të kontratës, Datën e përfundimit të projektit, vlerën e projektit. Referenca ose raporte te pranimit te punimeve.

Për këtë kërkesë të FDT-së GOE kanë ofruar Listën e projekteve të realizuara siç është kërkuar me FDT dhe e njëjta I plotëson të gjitha kërkesat përfshirë vlerën e kërkuar. Projektet janë realizuar nga GOE dhe të njëjtat përmbushin kërkesën e FDT-së, duke dëshmuar me referenca dhe pranime te punimeve mbi vlerën e kërkuar jo vetëm për lot 2 por edhe për lot 7, andaj edhe AK e ka vlerësuar si kërkesë te përmbushur.
Shih dëshmitë disa nga projektet qe janë pune te ngjashëm me pranime te projekteve ku lideri i grupit ka realizuar projektet te ngjashme sipas kërkesës:

AK në përgjigjen e dhënë sa i përket referencave përveç shkeljeve të lartcekura ne Pretendimin 2, bënë shkeljen e radhës duke tentuar të ndërroj termat (kërkesat) e FDT, ku aty thuhet shumë qartë OE duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses projekte në rregullim ose pastrim të lumenjeve në 3 vitet e fundit e jo siç pretendon AK në përgjigjen e tij të dhënë ku thot: "Shih dëshmitë disa nga projektet që janë punë të **ngjajshme** me pranim te projekteve ku Lideri i grupit ka realizuar projekte të **ngjajshme** sipas kërkesës".., do të thotë AK ka provuar që të arsyetojë referencat të cilat nuk janë ashtu siç janë kërkuar në FDT, andaj AK është dashur që në fazë të parë të eliminoj GOE të shpallur si të suksesshëm, të ndryshojë vendimin pas Kërkesës së Rishqyrtimit të na shpallë ne si GOE të përgjegjshëm sepse jemi më të lirët dhe të vetmit që i plotësojmë kërkesat e FDT.
Po ashtu AK gjatë fazës së njoftimit për kontratë ka pranuar një Kërkesë për Rishqyrtim për kriteret e vendosura ku me dt. 25.04.2024 ka marr Vendim mbi refuzimin e kësaj Kërkesës për Rishqyrtim të parashtruar nga OE BERISHA COMPANY SH.A, më poshtë gjeni Pretendimin e OE dhe Përgjigjen e AK i cili është si vijon:

Pretendimi Nr.1: -Ne si OE pretendojmë se ky kriter është diskriminues,favorizues dhe në kundërshtim me LPP për arsye se si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri duhet të mirren parasysh edhe kontratat e ngjajshme siq janë Rregullimi i kanalizimeve, ujësjellëseve etj. Sepse edhe në këto lloje të kontratave janë kryer punë siq janë: Shënim i trasesë,Kontrollimi dhe evidentimi i instalimeve nëntokësore,Pastrimi i terenit, Gërmimi i dheut si dhe Demolimi i pengesave të ndryshme ashtu siq do të kryhen në projektin në fjalë e jo vetëm kontrata të njejta siq e keni kërkuar në FTD. Andaj kërkojmë që ky kriter të ndryshohet

Përgjigje për pretendimin nr.1

Kjo kërkesë nuk mund të ndryshohet dhe është në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik sepse ketu janë kërkuar kontrata të natyrës se projektit e cili ka me u ekzekutuar, ku kjo kërkesë sherben për të siguruar që OE që do të kontraktojm të kenë përvojë të mire dhe të suksesëshme në këtë fushë. E dime që në të kaluarën mungesa e profesionalizimit gjatë këtyre aktiviteteve ka çuar në pasoja serioze, duke përfshir edhe rrezikun e përmbytjeve nga lumenjët gjatë reshjeve të shiut. Prandaj ju kërkojm që të plotësoni kërkesat e dosjës së tenderit dhe njoftimit për kontratë për të garantuar sigurinë dhe cilësinë në projektin tonë.

Në këtë rast AK ka përdorë standarde të dyfishta në përgjigjet e tije ndaj kërkesës tonë dhe përgjigjen ndaj kërkesës së parashtruar për kritere nga OE BERISHA COMPANY SH.A duke devijuar nga kërkesat e FDT dhe njoftimit për kontratë, bashkangjitur gjeni vendimin e datës 25.04.2024.

Ndërsa sa i përket kontratave që i ka prezantu GOE të pretenduar për tu shpërblye me kontratë AK në përgjigjen e tij është munduar ti llogaritur si të **ngjajshme projektet e prezantuara.**

Edhe pse ne kemi shikuar ne detaje kontratat e GOE dhe ju kemi thënë se nuk i plotësojnë kërkesat e FDT dhe njoftimit për kontratë.

Pasi që AK ka bashkangjitur kontratat e GOE si të përgjegjshëm dhe si punë të ngjajshme ne në vazhdim do ju sqarona kontratat e prezantuar të GOE të përzgjedhur si të përgjegjshëm e projektet të cilat janë si vijon:

1. "LOT 2 MBROJTJA NGA PËRMBYTJA NGA LUMI OSUM NË ORIZAJ – BERTA" – vlera e referencës është 18,911,032.80 lekë, me 31.07.2023 kur është nënshkruar kontrata vlera e lekut në raport me euro ka qenë 104 lekë që d.m.th 18,911,032.80 lekë / 104 lekë = 181,836.85 euro por në këtë projekt OE FLED ka një marrëveshje të noteri për kryerjen e punimeve së bashku me OE ASI-2A CO, ne atë marrëveshje OE FLED ka 60% realizimin e punimeve që d.m.th referenca në vlerë 181,836.85 euro x 60% = 109,102.11 euro.
2. "DEVIJIMI I PËRROIT PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE TË BASHKISË KUÇOVË" – vlera e referencës është 17,879,880.00 lekë, kontrata e përfunduar në vitin 2020 vlera e lekut në raport me euro ka qenë 128 lekë që d.m.th 17,879,880.00 lekë / 128 lekë = 139,686.56 euro por e njëjta nuk është referencë sipas kërkesës së FDT dhe njoftimit për kontratë(pastrim dhe rregullim të lumenjëve).
3. "MBROJTJE NGA GËRRYERJET E LUMIT SHKUMBIN NË ZONËN THANASAJ LUSHNJE" – vlera e referencës është 11,267,297.00 lekë, kontrata e përfunduar në vitin 2022 vlera e lekut në raport me euro ka qenë 122 lekë që d.m.th 11,267,297.00 lekë / 122 lekë = 92,354.89 euro
4. "REHABILITIMI I VEND DEPOZITIMIT TË MBETJEVE TË NGURTA SKRAPAR" – kontrata e përfunduar në vitin 2023 në vlerë 105,557.00 euro por e njëjta nuk është referencë sipas kërkesës së FDT dhe njoftimit për kontratë (pastrim dhe rregullim të lumenjëve).
5. "LOTI 12 MBROJTJE NGA PËRMBYTJA NGA LUMI DEVOLL NË GEGË, BASHKIA KUÇOVË" – kontratë e prezantuar në mes të VELLEZERIT HYSA dhe FLED SH.P.K, e lidhur me 10.08.2022 në vlerë 36,000,000.00 lekë vlera e lekut në

raport me euro ka qenë 118.07 lekë që d.m.th 36,000,000.00 lekë / 118.07 lekë = 304,903.87 euro, pas hulumtimeve dhe në mungesë të prezantimit të kontratës bazë në mes të VELLEZERIT HYSA në cilësinë e sipërmarrësit dhe DREJTORIA E UJITJES DHE KULLIMIT KORÇË në cilësinë e investitorit është e pamundur që kjo kontratë të merret për bazë sepse asnjëherë nuk ka ndodhur që 100% e punimeve të nënkontraktohet, prandaj lindë dyshimi se është një kontratë fiktive

Ndërsa sa i përket partnerit EUROFAMIS SH.A nuk ka asnjë referencë të njëjte siç është kërkuar në FDT.

Provë shtesë: Kontratat e prezantuar nga LIDERI

Pretendimi 3. GOE nuk është i përgjegjshëm sipas FDT të Kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale Neni 9.1 & 9.2 ku është kërkuar:

Kapaciteti teknik dhe professional:

Të gjitha LOTET Një Udhëheqës i Punishtes inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë - Hidroteknik, minimum 5 vite pervoj pune pas diplomimit. Të jetë i certifikuar për siguri dhe shendet në punë.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Vendimi mbi caktimin e Udhëheqësit të punimeve nënshkruar nga kompania dhe nga Udhëheqësi i propozuar i punimeve; Udhëheqësi i punimeve të jetë Ing. i dipl i Ndërtimtarisë-drejtimi Hidroteknik. (diploma e noterizuar). Udhëheqësi i punimeve të ketë së paku 5 vite përvojë pas diplomimit) (të dëshmohet me CV dhe Referencë). Kontrata e rregullt e punës , në rast se angazhimi është vetëm për këtë projekt , duhet të ketë kontratë për këtë projekt e nënshkruar nga të dy palët tek noteri. Të deshmohet se ka një referenc në pastrim ose rregullim të lumenjeve në vleren e parashikuar të ofertës. Certifikata e noterizuar nga vet inxhinieri për siguri dhe shendet ne punë.

GOE ka prezantuar si KONTRATË PUNE ME KOHË TË CAKTUAR me znj. Zarife Sallahu si INXHINIERE E HIDROTEKNIKËS – Udhëheqëse e Punishtës, kjo kontratë e prezantuar nuk është sipas kërkesës së dosjes dhe FDT sepse është kontratë me afat të caktuar siq ceket në NENI 3 ..... e punësuara është e obliguar të filloj punën nga data 04.01.2024 dhe kjo kontratë përfundon me 31.12.2024.

Në asnjë Nen të kontratës nuk thuhet se kontrata është me mundësi vazhdim, po ashtu të NENI 14 i kontratës thuhet: "Kontrata e punës ndërpritet: me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës....."

Ndërsa të FDT te KUSHTET DHE KËRKESAT E DËRGESËS – NENI 5.2 thuhet: "Afati kohore për fillimin dhe/ose përfundimin e kontratës: në muaj 12 ose në ditë ose fillim përfundim".

Po ashtu Vendimi i prezantuar për Udhëheqësin e Punimeve nuk është në emër të GOE por është prezantuar i nënshkruar dhe i vulosur vetëm partneri EUROFAMIS SH.A.

Oferta e prezantuar nga GOE është administravisht e papërgjegjshme sepse nuk është konform kërkesave të FDT.

Provë: Kontrata dhe Vendimin për caktimin e udhëheqësit

Përgjigja e AK lidhur me pretendimin e lart cekur

Sa i përketë këtij pretendimi ju njoftojmë edhe një here se ne bazë te Kërkesave te përcaktuar ne FDT dhe Njoftim për kontrate ku një kërkesë e till ka qene: **Të gjitha LOTET Një Udhëheqës i Punishtes inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë - Hidroteknik, minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Të jetë i certifikuar për siguri dhe shendet në punë.**
GOE kanë prezantuar inxhinieren znj.Zarife Sallahu për të cilën kanë ofruar dëshmitë e kërkuara.

Gjatë fazës së vlerësimit GOE ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së përfshirë kontratën, por mbetet përgjegjësi e OE të bëjë vazhdimin e kontratave për stafin. Ajo që është e rëndësishme për ne si AK, GOE e kanë plotësuar këtë kërkesë dhe pavarësisht që kontrata kana afat të caktuar, të njëjtat kanë plotësuar kërkesat e FDT-së. E njëjta përgjigje vlen edhe për stafin tjetër për të cilin OE ankues ka pretenduar për skadim të kontratave në një datë të ardhshme. Andaj bazuar ne faktet dhe dëshmitë e ofruar sa i përketë këtij pretendimi GOE i rekomanduar për kontrate i ka përmbushur këto kërkesa sipas FDT dhe Njoftimit për Kontrate. Bazuar ne atë qe u tha me larte edhe ky pretendim nga juaj, refuzohet si i pa baze.

Edhe në këtë përgjigje AK është në kundërshtim me kërkesat e FDT te KUSHTET DHE KËRKESAT E DËRGESËS – NENI 5.2 thuhet: "Afati kohore për fillimin dhe/ose përfundimin e kontratës: në muaj 12 ose në ditë ose fillim përfundim", sepse Udhëheqësi i Punishtes do të përfundoj kontratën e punës pa u përmbyll projekti në fjalë ku rrezikohet që punimet të mos kryhen sipas kontratës në mungesë te UDHËHEQËSIT sepse AK nuk duhet ndihet i sigurt ku thotë se mbetet përgjegjësi e OE të bëjë vazhdimin e kontratave me stafin.
Në këtë rast ne mendojmë se GOE nuk është i përgjegjshëm.

Pretendimi 4. Tek Kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale Neni 9.1 & 9.2 ku është kërkuar:

Kapaciteti teknik dhe professional: **Bachelor i Gjeodezise ose master i licencuar nga AKK minimum 4 vite pervoje pune pas diplomimit.**	

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Kopja e diplomes (noterizuar), kopja e licences e (noterizuar) Kontrata e punës (kopje e noterizuar) ose parakontratë për këtë projekt. Referenacat qe deshmojne per punet e kryera dhe pervojen ne projektet te natyres se ngjajshme se paku nje reference ne rregullimin ose pastrimin e lumenjeve.

.

Partneri i GOE EUROFAMIS SH.A ka prezantuar një KONTRATË PUNE ME KOHË TË PACAKTUAR me z. DURIM HOXHA si Bachelor i Gjeodezis, kjo kontratë është nënshkruar me dt. 03.05.2024, nëse i analizojmë dokumentet e prezantuar CV dhe Referencën tregon një mos përputhje sepse z.Durim Hoxha nuk ka prezantuar ne CV e tije se ka pasur bashkëpunim me herët me kompaninë EUROFAMIS SH.A, ndërsa kompania në fjalë ka prezantuar kontratën e lartcekur dhe një REFERENCË të dt. 05.01.2021 e cila nuk është reale sepse nuk prezantohet ne CV e z.Hoxha.
Pra kompania e lartcekur duhet prezantojë dëshmi bashkëpunimi me z.Hoxha për periudhën 2018-2021

Provë: Kontrata, CV dhe Referenca e z.Hoxha

Përgjigja e AK lidhur me pretendimin e lart cekur

AK pas shqyrtimi te këtij pretendimi ju njofton edhe një here se OE i rekomanduar për kontrate për lot 2 ka përmbushur kërkesën duke i prezantuar te gjitha dokumentacionet sipas kushteve te përcaktuara ne FDT dhe Njoftim për kontrate, andaj edhe AK-komisioni i vlerësimit ka vepruar konform LPP-se, Rregullave dhe Udhëzuesit për Prokurim Publik, duke i vlerësuar si kërkesës e përmbushur nga ana e GOE te rekomanduar për kontrate. Sa I përket pretendimit të CV-së për staf, dhe përvojës së stafit të ofruar, ju informojmë se GOE të rekomanduar ka ofruar dëshmitë e stafit, përfshirë CV-në siç është kërkuar. Të njëjtat kanë plotësuar kërkesën e FDT-së dhe ne si AK nuk mundë të I detyrojmë OE se qfar prezantojnë në CV-të e tyre. AK ka vlerësuar që CV-të janë në përputhje kërkesat e FDT. Bazuar ne atë qe u tha me larte edhe ky pretendim nga juaj, refuzohet si i pa baze.

Kjo përgjigje e AK tregon neglizhencën për vlerësim të mirëfillt sepse projektet për të cilën është lëshuar Referenca e që janë projekte të vetë AK, janë si vijon:

Projekti 1.

- **Titulli: Pastrimi i shtratit të lumit Marec**
- **Numri i prokurimit: 210-18-7030-5-2-1**
- **Vlera: 90,388.00 €**
- **Autoriteti Kontraktues: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor.**

Nëse e analizojnë Njoftimin për Kontratë për projektin në fjalë te Kapaciteti teknik dhe profesional nuk është kërkuar që të ketë Bachelor të Gjeodezisë,

Projekti 2.

- **Titulli: Pastrimi dhe rregullimi i lumit Drenica-Bardh i Madhe FushëKosovë**
- **Numri i prokurimit: 210-19-5557-5-2-1 & 210 19 040 521**
- **Vlera: 214,884.00 €**
- **Autoriteti Kontraktues: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor.**

Të Njoftimin për Kontratë te Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar NJË INXHINIER I DIPLOMUAR I NDËRTIMTARIS DREJTIMI I GJEODEZI - BACHELOR OSE MASTER ME 3 VITE PËRVOJË PUNE PAS DIPLOMIMIT- dëshmi përvojën ne projekte te natyrës se ngjajshme, pasi që inxhinieri i prezantuar nuk i ka plotësuar kushtet sepse i mungon përvoja në projekte të ngjajshme nuk ka mundur që të jetë as për këtë projekt, si dhe

Projekti 3.

- **Titulli: "Faza I-rë Rregullimi i shtratit të lumit Marec"**
- **Numri i prokurimit: 210-19-1800-5-2-1 & 210 19 009 521**
- **Vlera: 467,226.31€**
- **Autoriteti Kontraktues: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor.**

Edhe të ky projekt të Njoftimin për Kontratë te Kapaciteti teknik dhe profesional te pika 3 është kërkuar NJË INXHINIER I DIPLOMUAR I NDËRTIMTARIS OSE MASTER DREJTIMI I GJEODEZI, inxhinieri i prezantuar nuk i ka plotësuar kushtet sepse është Bachelor të Gjeodezisë.

Provë shtesë: Njoftimet për kontratë për projektet në fjalë

Pretendimi 5 Tek Kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale Neni 9.1 & 9.2 ku është kërkuar:

Kapaciteti teknik dhe professional:

(Pese) Punetore te trajnuar dhe certifikuar per pune te sigurte dhe ruajtjen e shendetit ne pune . Ku se paku njeri prej tyre të jetë i certifikuar për drenazhim të dheut.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Kontrata kopje e noterizuar, certifikatat, dhe të njejtit te kene nga nje reference per lumenj, leshuar nga kompania. Certifikata për drenazhimin e dheut të duhet të leshohet nga nje kompani e licencuar nga institucionet shtetrore.

.

Partneri i GOE EUROFAMIS SH.A ka prezantuar ka prezantuar KONTRATË PUNE ME KOHË TË PACAKTUAR për punëtoret si vijon:

z.ALBION MUSTAFA dt. e kontratës 04.01.2024,

z. FEHMI HOXHAJ dt. e kontratës 04.01.2024,

z. JETMIR BYTYÇI dt. e kontratës 04.01.2024,

z. JAHIR BYTYÇI dt. e kontratës 04.01.2024,

z. QAMIL GURI dt. e kontratës 04.01.2024 si dhe

z. SHKODRAN BYTYÇI dt. e kontratës 04.01.2024, kompania në fjalë ka prezantuar kontratën e punëtorëve dhe REFERENCË e njëjtë për të gjithë punëtorët e cila është dt. 05.01.2021, Pra kompania e lartcekur duhet prezantojë dëshmi bashkëpunimi e më hareshëm për periudhën 2018-2021, me punëtore në mënyrë që kjo REFERENCË të plotësojë kërkesën e FDT mos prezantimi i dëshmive tregon se GOE janë të papërgjegjshëm prandaj duhet eliminuar.

Provë: Kontrata, Referencat e punëtorëve

Përgjigja e AK lidhur me pretendimin e lart cekur

AK pas shqyrtimi te këtij pretendimi ju njofton edhe një here se OE i rekomanduar për kontrate për lot 2 ka përmbushur kërkesën duke i prezantuar te gjitha dokumentacionet sipas kushteve te përcaktuara ne FDT dhe Njoftim për kontrate, andaj edhe AK-komisioni i vlerësimit ka vepruar konform LPP-se, Rregullave dhe Udhëzuesit për Prokurim Publik, duke i vlerësuar si kërkesës e përmbushur nga ana e OE te rekomanduar për kontrate. Një kërkesë e till ka qene shume e qart **Kontrata kopje e noterizuar, certifikatat, dhe të njejtit te kene nga nje reference per lumenj, leshuar nga kompania. Certifikata për drenazhimin e dheut të duhet të leshohet nga nje kompani e licencuar nga institucionet shtetrore.** Dhe te njëjtën OE i rekomanduar e ka përmbushur me dëshmitë e ofruar për këtë kërkesë dhe te gjitha kërkesat tjera pasi qe kërkesat kane qene shume te qarta dhe dëshmitë e OE te rekomanduar kane qene te përmbushur nga ana e tij. Bazuar ne atë qe u tha me larte edhe ky pretendim nga juaj, refuzohet si i pa baze.

Në Pretendimin 5 AK ka konsideruar si të përmbushur kërkesat e FDT edhe pse ne kemi kërkuar dëshmi se këta punëtor kanë pasur marrëdhënie pune gjatë kohës sa kanë qenë projektet për të cilat ju ka lëshuar referencë, mungesa e dëshmisë nënkupton se kjo referencë nuk tregon gjendjen reale.

Pretendimi 6 Tek Kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale Neni 9.1 & 9.2 ku është kërkuar:

Kapaciteti teknik dhe professional:

Nje draft marreveshje e nenshkruar ne mes te OE dhe kompanise se sigurimeve per sigurimin e puneve dhe te punesuarve per kete project. Ne rast konzorciumi te perfshihen te gjithe anetaret e grupit

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Draft marreveshja origjinal e leshuar nga kompania e sigurimeve.

FLED & EUROFAMIS SH.A, ka prezantuar DRAFT – MARREVESHJE PËR OFRIMIN E MBULESËS SË SIGURIMIT nga Kompania ELSIG e cila nuk është sipas kërkesave të FDT dhe njoftimit për kontratë sepse kërkesa është shume e qartë aty thuhet: " Draft marrëveshja e nënshkruar ne mes te OE dhe kompanisë së sigurimeve.....".
GOE ka prezantuar – dorëzuar një Draft i cili nuk është i nënshkruar nga kompania e sigurimeve, me këtë rast GOE është i pa përgjegjshëm prandaj duhet eliminuar

Provë: Draft -Marrëveshje për Ofrimin e Mbulesës së Sigurimit

Përgjigja e AK lidhur me pretendimin e lart cekur

Sa i përketë këtij pretendimi aga ana e juaj nuk qëndron pasi qe duke u bazuar ne dëshmitë e ofruar GOE e ka përmbushur ketë kërkesë sipas kushteve te përcaktuara ne FDT dhe Njoftim për kontrate. Po ju bashkëngjisim edhe një here dëshmi draft marrëveshja e nënshkrua nga Kompania e Sigurimeve dhe OE i rekomanduar për kontrate. Shih dëshminë:

ELSIG

Kompania e Sigurimeve "Elsig" Sh.A.

Gjithçka që duhet ta keni!

Me 16.05.2024
Prishtinë

DRAFT-MARREVESHJE
PËR OFRIMIN E MBULESËS SË SIGURIMIT

E lidhur në mes të:

1. Kompanisë së Sigurimit " ELSIG", shoq. a. Ibrahim Shmajli nr. 3, Prishtinë, të cilën e përfaqësojnë drejtori i përgjithshëm Rustem Ishlozaj, në njërën anë dhe

2.Fled SHPK &Eurofamis SHA, me seli ne Kosmaç Nr. 107, Suhareka nr. Biznesit 811306431, të cilën e përfaqësojnë drejtori Ilir Byrqi, në anën tjetër.

Bazuar në bashkëpunimin reciprok në të kaluarën dhe te arrëmen me mes të KS " ELSIG", dhe noterëmarrjes **Fled SHPK &Eurofamis SHA** Kompania e sigurimeve " ELSIG", do t'i ofrojë mbulesë sigurimore noterëmarrjes **Fled SHPK &Eurofamis SHA** *për sigurimi:*

- Per sigurimin te pasurisë, bunës apo dëmtime te pjesëshme ne sigurim te prones, pajisjeve, makine te mëdhe, apo pasurisë se palës se trete.
- Për Personel, mbulesën sigurimore, lëndimet trupore, vdekjen ne shërbedhë, vdekja te punëtorët apo personit te trete.
- Për Automjete, mbulesa sigurimore për dëmtime materiale dhe jo materiale ndaj palëve te trete.

Te gjithë mbulesat te sigurimit do te kenë gjithë aplikimit te punimeve sipas kontratës **Ministria e Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës me nr. te Prokurimit: 210-24-3216-5-1-1 Me titëll: Pastrimi i lumenjve me nivel te Kosovës Lot 2 Lumi Toplluha Velezha-Prizren L=11500m Me Palën Nëse Noterëmarrja. Fled SHPK &Eurofamis SHA** do te jetë fituese e tenderit te kalkulojë, dëshirë mbulesa sigurimore do të jetë e llogaritur me harmoni me limitet e shumës te sigurimit që kërkohen ne kontratë te nënshkruar nga noterëmarrja **Fled SHPK &Eurofamis SHA dhe Autoriteti Kontrollues.** Perfitimi e sigurimit do të fillojë vetëm pasi të jetë e nënshkruar kontrata si dhe lëshuar nga Operatori Ekonomik për fillimin te policës te sigurimit.

Mbulesa e sigurimit do te jetë në pajtim me rregullat e BGJF-së, Kuadrit dhe Ligjit e Sigurimit.

Kjo Draft Marëveshje është përpunuar me dy kopje , nga një për secilën palë.

KS "Sigurimi" "ELISG", sh. a.

Kompania e Sigurimeve "ELSIG"
Rr.Ibrahim Shmajli nr. 03,
10000 Prishtinë, Kosovë

Fled SHPK &Eurofamis SHA

Telefon: +383 (0) 49 231 112/113
E-mail: office@kosfilgroup
Web: www.kosfilg.com

Bazuar ne atë qe u tha me larte edhe ky pretendim nga juaj, refuzohet si i pa baze.

AK edhe gjatë bashkëngjitjes së dëshmisë e cila është e njëjte me atë që ne ju kemi bashkangjitur ne kërkesën për rishqyrtim në të dy rastet tregon se Drafti nuk është sipas kërkesës së FDT dhe njoftimit për kontratë sepse është e pa nënshkruar nga ana e kompanisë së sigurimeve.

Kërkesa ka qenë shumë e qartë:

Kapaciteti teknik dhe professional:

Nje draft marreveshje e nenshkruar ne mes te OE dhe kompanise se sigurimeve per sigurimin e puneve dhe te punesuarve per kete project. Ne rast konzorciumi te perfshihen te gjithe anetaret e grupit

Pra kërkohet të jetë e nënshkruar nga të dy palët e jo e vulosur sepse në Draft Marrëveshje nënshkrimi nuk ekziston fare.

Pra të gjitha këto gjetje tregojnë se GOE të propozuar për kontratë janë të pa përgjegjshëm

Sa i për ketë OE tjerë edhe ne si GOE pajtohem me vendimin e AK.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u përmendën me lartë, kërkojmë nga ju që të merrni: VENDIM

APROVOHET , si e bazuar ankesa ,

ANULOHET, njoftimi dhe vendimi për dhënie të kontratës për **LOT 2 Lumi Toplluha, Velezha -Prizren L=11500m** te GOE **FLED & EUROFAMIS SH.A**, të kërkoj nga AK

që të na shpërblejë GOE "VB.TOFAJ" SH.P.K & "NIVA CONSTRUCTION" SH.P.K & HARST GROUP SH.P.K sepse jemi të vetmit që plotësojmë kushtet dhe kriteret e FDT

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale janë të konsiderueshme, sepse jemi përgatitur për ekzekutimin e kësaj kontrate dhe jemi GOE i përgjegjshëm, dëmi material do të jetë i lartë po qe se ANKESA nuk merret e bazuar.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar VB.TOFAJ SH.P.K. 810962193 JUNIK